



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, Ligjin Nr.02/L-59, për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Statutin e Filharmonisë së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall :

## KONKURS

**Titulli i punës:** Korist/e në Filharmoninë e Kosovës pesë (5) pozita

- 1 SOPRANO
- 1 ALT
- 1 TENOR
- 2 BASA

**Kategoria funksionale:** Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës

**Paga:** 337.50€

**Numri i referencës:** 22/2017

**I përgjegjet:** Drejtorit të Filharmonisë së Kosovës

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Interpreton në koncertet e Korit dhe Orkestrës së Filharmonisë së Kosovës;
2. Merr pjesë në provat e rregullta ditore në kohëzgjatje prej 4 orëve;
3. Kryen detyrat profesionale sipas pozicionimit në kor;
4. Paraprakisht përgatitë / ushtron partin koral në shtëpi në kohëzgjatje prej 4 orëve;
5. Interpreton pjesë / parte solistike sipas pozitës në kor;
6. I nënshtrohet audicionit periodik sipas dispozitave ligjore.

### **Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

1. Njohuri të duhura lidhur me profesionin e këndimit koral;
2. Aftësi për të punuar në grup me koristët e tjerë;
3. Shkathtësi të mira komunikuese dhe gatishmëri për punë me orar fleksibël të punës;
4. Përvoja në formacione korale profesionale dhe amatore është përparësi;
5. Arsimim profesional universitar në Drejtimin e Solokëndimit dhe të kenë sa më shumë prezantime individuale (recitale) dhe grupe koncertale.

### **Procedurat e konkurrimit:**

Përzgjedhja e koristëve rezident në Korin e Filharmonisë së Kosovës, bëhet përmes audicionit.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Ligji i Punës, Nr. 03/L-212, Ligji Nr.02/L-59, për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Statutin e Filharmonisë së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Koristet që pranohen përmes Konkursit publik, marrin kontrata dy vjeçare me mundësi të vazhdimit, sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

### **Dokumentet e nevojshme që kërkohen:**

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuara si vijon:

- Diplomën universitare, Drejtimi i Solokëndimit;
- Dëshminë mbi përvojën e punës profesionale;
- Dokumenti i identifikimi.

**Titulli i punës:** Instrumentist/frymor në Filharmoninë e Kosovës dy (2) pozita  
- 1 TROMPETIST  
- 1 KORNIST

**Kategoria funksionale:** Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës

**Paga:** 437.50€

**Numri i referencës:** 23/2017

**I përgjigjet:** Drejtorit të Filharmonisë së Kosovës

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

1. Interpreton në koncertet e Orkestrës dhe Korit të Filharmonisë së Kosovës;
2. Merr pjesë në provat e rregullta ditore në kohëzgjatje prej 4 orëve;
3. Kryen detyrat profesionale sipas pozicionimit në orkestër;
4. Paraprakisht përgatit / ushtron partin orkestral në shtëpi në kohëzgjatje prej 4 orëve;
5. Interpreton pjesë / parte solistike sipas pozitës në orkestër;
6. I nënshtrohet audicionit periodik sipas dispozitave ligjore.

**Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

1. Njohuri të duhura lidhur me profesionin e instrumentistit frymor;
2. Aftësi për të punuar në grup me instrumentistë të tjerë në orkestër;
3. Shkathhtësi të mira komunikuese dhe gatishmëri për punë me orar fleksibël të punës;
4. Përvoja në formacione orkestrale e kamertale është përparësi;
5. Arsimit profesional universitar në Drejtimin Instrumental-Frymor dhe të kenë sa më shumë prezantime individuale (recitale) dhe grupore koncertale.

**Procedurat e konkurrimit:**

Përzgjedhja e instrumentistëve në Filharmoninë e Kosovës, bëhet përmes audicionit.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

**Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Ligji i Punës, Nr. 03/L-212, Ligji Nr.02/L-59, për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Statutin e Filharmonisë së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Instrumentistët që pranohen përmes Konkursit publik, marrin kontrata dy vjeçare me mundësi të vazhdimit, sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

**Dokumentet e nevojshme që kërkohen:**

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuara si vijon:

- Diplomën universitare, Drejtimin Instrumental-Frymor ;
- Dëshminë mbi përvojën e punës profesionale;
- Dokumenti i identifikimi.

**Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi është i hapur pesëmbëdhjet (15) ditë pas ditës së shpalljes.

**Data e fundit e aplikimit është: 18.05.2017**

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 35. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>)